



Nr. 280 Prot. ....  
Data 5-12-19 Nenshkrimi  
H. Joone

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



Nr. 07/24 Regj

Pogradec më 26.11.2019

**D r e j t u a r:** - Gjkata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, POGRADEC.  
- Gjkata e Rrethit Gjyqësor Korçë, KORÇË.  
- Bashkia Pogradec, POGRADEC .  
✓ - Bashkia Maliq, MALIQ .


**Për dijeni Debitorit:** Olgert Vladimir Agolli,  
Pirg, MALIQ  
**Kreditorit:** Gramoz Abedin Veliaj  
Uznovë, BERAT.

**L ë n d a :** Në ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe të "Titullit ekzekutiv" me Vendim Nr.92, datë 02.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në bazë të nenit 568 të K.Pr.Civile, bashkëlidhur po ju dërgojmë Vendimin për shpalljen e ankantit dhe Njoftimin për shitje të sendit të luajtshëm në pronësi të debitorit **Olgert Vladimir Agolli**, banues në Pirg, Maliq, për afishimin njoftimeve të vendimit Nr.07/23, të datës 26.11.2019 dhe të njoftimit për shitje, të përmbaruesit gjyqësor privat Erzen Qeva, në tabelat e njoftimeve të institucionit tuaj.  
Faleminderit për bashkëpunimin.

Lidhje 3 faqe.

ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K

PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT  
Erzen QEVA



D. Shyq. Ruben  
- M. A. Pirg  
Dt. 05.12.2019  
Qeja

Nr. 121 Prot  
Dt. 05.12.19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



Nr. 07 / 23 Regj

Pogradec më 26.11.2019

**D r e j t u a r** Debitorit: Olgert Vladimir Agolli.  
Pirg,

MALIQ

Kreditorit: Gramoz Abedin Veliaj  
Uznovë,

BERAT.

**V E N D I M**

(Mbi Shpalljen e Ankandit të dytë)

Në Pogradec sot më datën 26.11.2019.

Unë Erzen Z Qeva, përmbarues gjyqësor privat, pranë Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat "QEVA" Sh.p.k, me adresë lagjia Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec, pasi studjova materialet e dosjes përmbarimore me Nr. 07 regjistri, në zbatim të "Titullit ekzekutiv" me Vendim Nr.92, datë 02.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

**K O N S T A T O V A**

Se në datë 10.09.2018, është depozituar kërkesa e kreditorit Gramoz Abedin Veliaj, pranë Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat "QEVA" Sh.p.k, është regjistruar çështja përmbarimore me Nr.07 rregj, regjistruar më datën 10.09.2018 , të transferuara nga Shoqëria Përmbarimore "616/A" -Sh.p.k, Pogradec, me palë:

**Kreditor : Gramoz Veliaj.**

**Debitor : Olgert Agolli.**

**Me objekt : Kthim shume.**

Në kushtet kur për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimi me Nr.92, datë 02.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile, nga ana e Përmbaruesit Gjyqësor Privat Erzen Qeva, ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm për detyrimin e debitorit Olgert Agolli, të paguajë në total detyrim në vlerën 1.015.280 (Një million e pesëmbëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë) lekë (Përfshirë detyrim, shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore plus tatifën e shërbimit përmbarimor) në favor të kreditorit .

Me vendimin me Nr. 07/1 prot, të datës 17.09.2018, drejtuar DRSHTRR, Korçë, u vendos sekuestro konservative mbi sendet e luajtshme të debitorit Olgert Agolli, P.F. "Olgert Agolli", mbi sendin e luajtshëm "Kamjoçinë" (Furgon), e markës Mercedes Benz, 211 CDI Sprinter, me shasi Nr; EDB9026621R664227, viti prodhimit 2004, me targë AA 723RG, dhe sendeve të tjera në pronësi të debitorit.

Në datën 02.09.2019, në bazë të nenit 552, 554 u njoftuan palët për caktimin e çmimit me marrveshje të cilët nuk kryen njoftimin me shkresë për çmimin apo me rrugë elektronike të Shoqërisë Zyrë e Përmbarimit Privat "QEVA" shpk, nga ana e përmbaruesit gjyqësor më datën 12.09.2019, u mor vendimi për caktimin e ekspertit vlerësues të sendeve të luajtshme "Linja teknologjike, makineri e pajisje" Znj.Mirela Behluli (Nazari), eksperte pranë Shoqërisë "AMAP-REV" sh.p.k, me NIPT - L91702027I, me adresë Nj/Bashkiake Nr.2, Rr "Hoxha Tasim" Nr.32, Tiranë, të cilën kreu akt-ekspertimin me vlerë tregu e vlerësuar nga eksperti në shumën 420.000 ( Katërqind e dy mijë) lekë, ku u mor vendimi për caktimin e çmimit me Nr. 07/14 prot, të datës 30.09.2019.

Në mbështetje të nenit 549 të K.Pr.Civile, më datë 30.09.2019, ju dërgua lajmërimi se sendi i sekuestruar dhe vlerësuar brenda 7 ditësh, do të nxiret për shitje në ankand në rast të mos përmbushjes të detyrimit.

Më datën 14.10.2019, u shpall ankandi për shitjen e sendit të luajtshëm në vlerën 336.000 (Treqind e tridhjet e gjashtë mijë) lekë, ku më datën 13.11.2019, u zhvillua dhe u mbull ankandi, nuk u arrit të shitej pasi nuk u paraqitën ofertues.

Më datën 14.11.2019, në bazë të nenit 557 të K.Pr.Civile, u njoftuan palët se brenda 10 (Dhjetë) ditësh do të bëhet shpallja me çmimin e të ri, në masën 30 % më të ulët se çmimi i ankantit të parë, në shumën 235.200 (Dyqind e tridhjet e pesë mijë e dyqind) lekë, për llogari të kreditorit Gramoz Veliaj.

Në këto kushte, pas kalimit të afatit, po organizohet ankandi i dytë me një çmim të ri 30% më të ulët nga çmimi i caktuar në ankandin e parë, çmimi i ri është në vlerën 235.200 (Dyqind e tridhjet e pesë mijë e dyqind) lekë. Në këto kushte: Bazuar në nenin 554 ,557 e vijues të K.Pr.Civile .

## V E N D O S A

Të shpall ankandin për shitjen e sendit të luajtshëm në pronësi të debitorit Olgert Vladimir Agolli, mbi sendin e luajtshëm “Kamjoçinë”(Furgon), e markës Mercedes Benz, 211 CDI Sprinter, me shasi Nr; EDB9026621R664227, viti prodhimit 2004, me targë AA 723RG, e ndodhur në në L.1, Rruga Industriale, Magazinat e Mehdi Muçllari, Pogradec.

Shitja e sendit do të bëhet pasi të kenë kaluar 15 ditë nga dita e shpalljes së ankandit.

Çmimi fillestar i ankandit për shitjen e sendit të luajtshëm është 30 % më të ulët se çmimi i ankantit të parë, në shumën 235.200 (Dyqind e tridhjet e pesë mijë e dyqind) lekë.

Ankandi për shitjen e objektit do të zhvillohet në Zyrën e Shoqërisë Zyrë e Përmbarrimit Privat “QEVA” Sh.p.k, me adresë L. Nr.3, Rruga “Andon Xoxe”, Pogradec, pasi të kalojnë 15 ditë nga shpallja e ankandit, do të fillojë shitja e objektit që do të vazhdojë 15 ditë dhe përfundon në **datën 26 Dhjetor 2019, ditën e Enjte, orën 15.30.**

Sejcili ofertues duhet që para fillimit të ankandit të depozitojë 10% të vlerës e sendit të luajtshëm të caktuar në këtë shpallje, si garanci pranë Shoqërisë Zyrë e Përmbarrimit Privat “QEVA” Sh.p.k, Pogradec, ose pranë Raiffeisen Bank, në Nr.Llog. 0001367009 , IBAN AL42 2024 2004 0000 0000 01367009 SGSBALTX.

Pagesa e ofertuesit për blerjen e sendit të luajtshëm paguhet e gjithë shuma gjatë zhvillimit të ankantit, duke zbritur 10% të vlerës të parapaguar.


Një shpallje për shitje në ankand afishohet në hyrjen kryesore të Zyrës së Shoqërisë Zyrë e Përmbarrimit Privat “QEVA” Sh.p.k , një në vendin ku ndodhet sendi i luajtshëm, një në tabelat e Njoftimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Korçë, një në tabelat e Njoftimeve të Bashkisë Pogradec dhe Bashkia Maliq, Gazeta Panorama dhe Gazeta Shekulli.

Ky vendim mbahet në tre kopje ku njëra qëndron në dosjen përmbarrimore ndërsa tjetra ju komunikohet palëve.

**ZYRË E PËRMBARRIMIT PRIVAT “QEVA” SH.P.K**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT**

**Erzen QEVA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



**SHPALLJE PËR SHITJE SENDI TË LUAJTSHËM**

ZYRA E SHOQËRISË ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K, POGRADEC, NJOFTON SHPALLJE PËR SHITJE SENDIT TË LUAJTSHËM NË ANKAND SENDIN E LUAJTSHËM TË DEBITORIT OLGERT VLADIMIR AGOLLI, E PËRBËRË "KAMJOÇINË (FURGON)", E MARKËS MERCEDES BENZ, 211 CDI SPRINTER, ME SHASI Nr.WDB9026621R664227, ME TARGË **AA 723RG**, NGJYRA BARDHË, VITI I PRODHIMIT 2004, E NDODHUR NË RRUGA INDUSTRIALE, L.1, MAGAZINA E MEHDI MUÇLLARIT, POGRADEC, E NXJERRË PËR SHITJE NË ANKANT ME VLERË FILLESTARE **235.200 (DYQIND E TRIDHJET E PESË MIJË E DYQIND) LEKË**.

SHITJA E SENDIT TË LUAJTSHËM DO TË BËHET NË ZYRA E SHOQËRISË SHËRBIMI PËRMBARIMOR "QEVA" SH.P.K, POGRADEC, KJO SHPALLJE DO TË QENDROJË 15-DITË, DO TE MBAROJË NË PËRFUNDIM TË ORARIT ZYRTAR TË DITËS SË FUNDIT DATË 26.DHJETOR 2019, DITËN E ENJTE, QË ËSHTË DHE DATA E FUNDIT E ZHVILLIMIT TË ANKANTIT TË DYTË.

SEJCILI OFERTUES QË DO TË MARRË PJESË NË ANKAND DUHET TË DEPOZITOJË NË RAIFFEISEN BANK, NË Nr.Llog. 0001367009, OSE PRANË SHOQËRISË ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K, VLERËN PREJ 10% TË ÇMIMIT FILLESTAR TË SENDIT TË LUAJTSHËM DHE PAGIMIN E PLOTË TË SHUMËS PASI SHPALLET FITUES NGA OFERTA E DHËNË.

PERSONAT E INTERESUAR PËR TËRHEQJEN E DOKUMENTACIONIT TË ANKANTIT DUHET TË PARAQITEN PRANË ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K, POGRADEC, ÇDO DITË NGA ORA 08—16.00

OFERTAT SËBASHKU ME DOKUMENTACIONIN E TËRHEQUR DUHEN TË DEPOZITOHEN PRANË KËSAJ ZYRE NË ZARF TË MBYLLUR DERI MË **DATËN 26 DHJETOR 2019, DITËN E ENJTE, ORA 15.30.**

**U SHPALL SOT NË POGRADEC MË DATËN 26.11.2019.**

**ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K  
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT**

**Erzen QEVA**

